



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

Nr.____ Prot.

Datë : 23 /06 / 2009

VENDIM

Nr.118, datë 29.05.2009

“Për

disa rekomandime për aktet ligjore dhe nënligjore që ndikojnë në nivelin e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë të karburanteve”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Lindita	MILO(LATI)	Kryetar
Lush	PERPALI	Zv/kryetar
Servete	GRUDA	Anëtar
Koço	BROKA	Anëtar
Rezana	KONOMI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 29 /05 /2009, shqyrtoi çështjen me:

Objekt:

Vlerësimi i akteve ligjore dhe nënligjore që ndikojnë në nivelin e konkurrencës në tregun e karburanteve

Baza ligjore:

- Ligji nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar, neni 24, gërma “f”, neni 70, pika 2

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Raportit të vlerësimit mbi kufizimet e konkurrencës në tregun e karburanteve nga aktet ligjore dhe nënligjore dhe zbatimi i tyre, të përgatitur nga grupi i punës;
- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës;
- Pretendimeve të palëve nën hetim, në formë të shkruar dhe në seancat dëgjimore të datës 26 Dhjetor 2008 dhe 26 Janar 2009

VËREN SE:

I. Fusha e zbatimit të ligjit për mbrojtjen e konkurrencës

Ligji Nr. 9121 datë 28. 07. 2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” zbatohet për ndërmarrjet dhe grupimet e ndërmarrjeve, të cilat në mënyrë të

drejtpërdrejtë ose të tërthortë ndikojnë ose mund të ndikojnë në treg dhe që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë

II. Kuadri ligjor

Komisioni i Konkurrencës ka marrë në shqyrtim një sërë aktesh ligjore dhe nënligjore që kanë impakt në konkurrencën e lirë dhe efektive në treg si dhe është njohur me ankesat e ndërmarrjeve të tjera në treg gjatë seancave dëgjimore.

Tregu i karburanteve rregullohet nga këto akte ligjore dhe nënligjore

- Ligji Nr. 7746 datë 28. 07. 1993 “Për hidrokarburet” (kërkimi dhe prodhimi, i ndryshuar);
- Ligji Nr. 8450 datë 24. 02. 1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës dhe nënprodukteve të tyre” (i ndryshuar);
- Ligji Nr. 9595 datë 27. 07. 2006 “Për krijimin e Inspektoratit Qendror Teknik”;
- Ligji Nr. 7928 datë 27.04.1995“Për tatimin mbi vlerën e shtuar”
- Ligji Nr. 8976 datë 12.12.2002 “Për akcizat”; /// ka ndryshuar
- VKM Nr. 170 datë 25. 04. 2002, “Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e lejeve dhe autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre” (i ndryshuar);
- VKM Nr. 808 datë 05. 11. 2004 “Për mbajtjen dhe menaxhimin e rezervës së sigurisë për naftën, gazin dhe nënprodukteve të tyre” (i ndryshuar);
- Udhëzimi i Ministrit të Financave Nr. 17 datë 13. 05. 2008 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”,

III. Efektet e kuadrit ligjor mbi konkurrencën

Komisioni i Konkurrencës, pasi është njohur me aktet ligjore dhe nënligjore, vlerësimin ligjor e ka ndarë në disa çështje kryesore si vijon¹:

1. Ligji për hidrokarburet 8450 datë 24.02.1999
2. Ndikimi i kursit të këmbimit të aplikuar nga organet doganore;
3. Ndikimi i Udhëzimit Nr. 17 datë 15. 05. 2008 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”;
4. Ndikimi i praktikave të vlerësimeve tatimore

III - 1. Ndikimi i legjislacionit për hidrokarburet mbi konkurrencën në këtë treg

Ligji Nr. 8450, datë 24.02.1999² “Për përpunimin transportimin dhe tregtimin e naftës gazit dhe nënprodukteve të tyre”, ka krijuar bazën e nevojshme ligjore për rregullimin e aktiviteteve në lidhje me produktet e naftës.

1 Komisioni i Konkurrencës ka marrë në shqyrtim vetëm ato ligje dhe aktet nënligjore, për të cilat mendohet se sjellin kufizime apo shtrembërime të konkurrencës në treg.

2 Ligji është përditësuar me: Ligjin Nr. 9128 datë 08. 04. 2004, Ligjin Nr. 9574 datë 03. 05. 2006, Ligjin Nr. 9595 datë 27. 07.2006

Në bazë të nenit 17 të këtij Ligji, personat juridikë që ushtrojnë veprimtari të përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës bruto, gazit natyror dhe nënprodukteve të tyre, përpara fillimit të ushtrimit të veprimtarisë janë të detyruar të pajisen me leje përkatëse tregtimi ose autorizimi. Mënyra e pajisjes së tyre me leje përkatëse tregtimi është përcaktuar me VKM Nr. 170 datë 25. 04. 2002 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre"³.

Me anë të këtij ligji, është lejuar integrimi vertikal i këtyre shoqërive të tregtimit me shumicë, i cili institucionalizohet me anë të pjesëmarrjes në kapitalin themeltar (aksione apo kuota) në shoqëritë e tregtimit me pakicë. Ky kushtëzim ligjor krijon kosto shtesë për ndërmarrjet e tregtimit me shumicë, duke sjellë një rritje të barrierave në hyrje apo në dalje.

Mos-kushtëzimi i ndërmarrjeve me shumicë që të krijojnë subjekte të veçanta për tregtimin me pakicë, do të sjellë rritjen e transparencës për konsumatorët në treg dhe në këtë mënyrë, rritet edhe konkurrenca midis markave të ndryshme. Ligji duhet të përcaktojë gjithashtu që tregtarët me shumicë të mos vendosin çmime apo kushte të tjera tregtimi favorizuese ndaj stacioneve në pronësi, apo në administrim të tyre përkundrejt stacioneve të bardha".

Sipas këtij Ligji, marrëdhëniet midis shoqërive të tregtimit me shumicë dhe atyre me pakicë, rregullohet me anë të kontratave të furnizimit që lidhin ndërmjet tyre. Ligji 8450 ka përmendur kontratën e furnizimi, por nuk ka përmendur kushtet bazë të kësaj kontrate.

Në mënyrë që të shmanget përfshirja e kushteve që mund të ndikojnë në konkurrencën e lirë dhe efektive, Ligji duhet të përcaktojë se këto kontrata, nuk duhet të përmbajnë kushte që përcaktojnë çmimet në treg. Pra, Ligji duhet të parashikojë se në këto kontrata, duhet të ndalohej që të përcaktohet çmimi i shitjes me pakicë, vendosja e çmimeve minimum, si dhe vendosja e kushteve të tjera të tregtimit, që në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mund të çojnë në përcaktimin e çmimit⁴. Këto kontrata duhet të monitorohen nga Autoriteti i Konkurrencës, për të shmangur fiksimin e çmimit me anë të kontratave të furnizimit ndërmjet shitësve me shumicë dhe atyre me pakicë.

III – 2. Ndikimi i kursit të këmbimit të aplikuar nga organet doganore sipas nenit 40 të "Kodit doganor".

Gjatë periudhës së hetimit një element tjetër në vlerësimin e çmimit të karburanteve në treg, është përcaktimi i ndikimit në çmimin e karburanteve të ndryshimit të kursit të dollarit (USD) dhe taksat doganore. Periudha e marrë në analizë i përket periudhës Korrik - Tetor 2008. Kursi i këmbimit, i përdorur nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, ndryshon nga kursi ditor zyrtar i publikuar në Banka e Shqipërisë. Kursi i përdorur nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, bazohet në nenin 40 të Kodit doganor të Republikës së Shqipërisë.

³ Kjo VKM është ndryshuar me VKM Nr. 563 datë 27. 08. 2004 dhe VKM Nr. 1047 datë 16. 07. 2008.

⁴ Praktika të tilla përshkruhen në udhëzuesin e Komisionit të BE, mbi Kufizimet Vertikale "Guidelines on Vertical Restraints (2000/C 291/01)", para. 47.

Për të përcaktuar efektin e ndryshimit të kursit të këmbimit të mësipërm, janë vlerësuar të gjitha faturat e blerjes së karburanteve, me kursin ditor zyrtar të Bankës së Shqipërisë, nga ku rezultoi se, efekti i ndryshimit të kursit në vlerë absolute për periudhën Korrik – Tetor 2008 është:

- Nafta D2 deri 5 lek / litër ose në terma relative në vlera 3-7%;
- Nafta D1=5.5 lek / litër ose në terma relative nga 3-7%;
- Benzina = 3.75 lek / litër ose në terma relative 4-6.7 %.

III – 3. Ndikimi i Udhëzimit Nr. 17 datë 15. 05. 2008 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar”⁵ të Ministrit të Financave

Subjektet e ndryshme që veprojnë në tregun e hidrokarbureve kanë pretenduar se Udhëzimin Nr. 17 datë 15.05.2008 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar” dhe amendimet që i janë bërë këtij Udhëzimi, çojnë në kufizim të konkurrencës⁶. Sipas pikës 9.4 të këtij Udhëzimi importuesit dhe prodhuesit vendas të karburanteve, konsiderohen si furnizues të nivelit të parë (kryesor) dhe furnizojnë me shumicë shoqëritë e tregtimit me pakicë, të cilat më pas, furnizojnë me të njëjtin mall klientët, që normalisht janë konsumatorë finale.

Pra, me anë të këtij Udhëzimi, për efekt të regjimit fiskal në lidhje me aplikimin e TVSH, kalimi nga importuesit ose shoqëritë e tregtimit me shumicë tek konsumatorët finalë, (fundorë) bëhet nëpërmjet shoqërive të tregtimit me pakicë. Në këtë skemë, bëjnë përjashtim vetëm rasti kur kemi të bëjmë me konsumatorë të mëdhenj, për të cilat shoqëritë e tregtimit me shumicë mund të furnizojnë direkt këta të fundit, pa qenë e nevojshme të aplikohet skema e sipërcituar.

Ky Udhëzim ka përcaktuar se: “shoqëria e tregtimit me pakicë është në rolin e agentit dhe të përfaqësuesit në shitjen e mallit me pakicë për llogari të shoqërisë së tregtimit me shumicë, si dhe nuk e konsideron shoqërinë e tregtimit me pakicë, si zotëruese të mallit edhe pasi e blen atë nga shoqëria e tregtimit me shumicë”.

Ky Udhëzim për efekt të regjimit fiskal të TVSH gjithashtu ka parashikuar se ndërmjet shoqërisë së tregtimit me shumicë dhe shoqërisë së tregtimit me pakicë, duhet të ekzistojë një kontratë, ku të jenë vendosur të paktën këto elementë:

- të jetë e përcaktuar qartë roli i shoqërisë së tregtimit me pakicë si agjente , në mënyrë që të kuptohet se agjenti po kryen një furnizim të shërbimit për llogari të shoqërisë së tregtimit me shumicë dhe jo për llogari të veprimtarisë së tij ekonomike;
- të jetë përcaktuar qartë që, shoqëria e tregtimit me pakicë në rolin e agentit nuk është ekonomikisht zotëruese e mallit, për rastin konkret karburantit, të cilin e ka furnizuar për llogari të kryesorit;

⁵ Ky udhëzim, është përditësuar me Udhëzimin Nr. 18 datë 18. 06. 2008 “Për Disa Shtesa në Udhëzimin Nr. 17 datë 13. 05. 2008 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar”, Udhëzimin 17/1 datë 05. 08. 2008 “Për një Ndryshim në Udhëzimin Nr. 17 datë 13. 05. 2008 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar”, udhëzimin nr 17/2 te datës 05.11.2008(ky udhëzim nuk është publikuar në Fletoren Zyrtare); Udhëzimin Nr. 17/3 datë 13. 11. 2008 “Për Disa Shtesa në Udhëzimin Nr. 17 datë 18. 06. 2008 “Për tatimin Mbi Vlerën e Shtuar”, hyrë në fuqi në datën 26 nëntor 2008 (fletore zyrtare Nr. 176 viti 2008); Udhëzimin Nr. 17/4 datë 26. 12. 2008 hyrë në fuqi në datë 15. 01. 2009 (publikuar në fletoren zyrtare Nr. 203 të vitit 2008).

⁶ Shoqata e Shoqërive të Hidrokarbureve, ka paraqitur një kërkesë pranë Gjykatës kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, ku kërkon shfuqizimin e udhëzimit nr.17/1, datë 05.08.2008, me arsyetimin se ky udhëzim cenon parimin kushtetues ku ekonomia shqiptare bazohet në ekonominë e tregut (neni 11 i Kushtetutës së RSH). Ky pretendim është rrëzuar nga Gjykata Kushtetuese me anë të vendimit nr. 12 datë 28.04.2009.

- shoqëria e tregtimit me pakicë, nuk mund të furnizojë në një vendndodhje biznesi, mallra të së njëjtës natyrë të furnizuar nga shoqëri të ndryshme të tregtimit me shumicë;
- të jetë përcaktuar qartë që shoqëria e tregtimit me pakicë, në rolin e agentit, nuk mund të ndryshojë çmimin e furnizimit të mallit që i është faturuar prej shoqërisë së tregtimit me shumicë;

Në këtë Udhëzim parashikohet që çmimi i vendosur në faturën që i lëshohet nga shoqëria e tregtimit me shumicë shoqërisë së tregtimit me pakicë, është ai i shitjes me pakicë dhe mbi vlerën e tatueshme të çdo furnizimi aplikohet TVSH në shkallën tatimore 20%. Ajo deklarohet si TVSH e mbledhshme nga personi që luan rolin e kryesorit dhe konsiderohet si TVSH e zbritshme për blerësin, brenda përcaktimeve të nenit 33 të ligjit “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”.

Ky Udhëzim mund të krijojë premisa për kufizimin e konkurrencës në tregun e shitjes me pakicë të karburanteve. Siç u citua dhe më sipër, në këtë Udhëzim, është përcaktuar roli i shoqërisë së tregtimit me pakicë si agente dhe përfaqësuese e shoqërisë së tregtimit me shumicë. Nëpërmjet deklarimit të cmimit të shitjes me pakicë në faturat e shitjes me shumicë mundësohet transparencë e çmimeve të aplikuara. Marrëdhëniet midis ndërmarrjeve që operojnë në nivele të ndryshme tregtimi të karburanteve, organizohen në bazë të kontratave bilaterale, me afate dhe kushte të përcaktuara, bazuar në vullnetin e lirë të tyre. Pra, aktet normative në fjalë, nuk i kushtëzojnë apo ngurtësojnë këtë marrëdhënie bilaterale, ku stacionet e bardha mund të përzgjedhin lirshëm midis ndërmarrjeve që shesin me shumicë për kushtet më të favorshme konkurrese. Pra, konkurrenca është e përqendruar në nivelin e shitjes me shumicë.

Nga ana tjetër, kjo skemë rrit transparencën në treg, duke siguruar një zbatim më të mirë të politikave publike në fushën e tatimeve, duke sjellë një përfitim të përgjithshëm për shoqërinë. Gjithashtu, duhet pasur parasysh se ky Udhëzim nuk ndalon ndërmarrjet e tregtimit me pakicë që të konkurrojnë me njëra tjetrën, brenda komisionit të përcaktuar me marrëveshje nga palët.

IV. Ndikimi i vlerësimeve tatimore

Bazuar në parashtrimet dhe evidencat e paraqitura nga palët gjatë seancave dëgjimore, konstatohet se ndaj ndërmarrjeve objekt hetimi aplikohen praktika të rivlerësimeve të çmimeve nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ose degët e saj në qarqe. Këto praktika vështirësojnë ndjeshëm gjykimin në mënyrë objektive mbi sjelljen e firmave në këtë treg.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24 gërma “f” të Ligjit Nr. 9121 datë 28. 07. 2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”

VENDOSI:

- I. T’i rekomandojë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë:

- Ndryshimin e nenit 14 pika 3 të Ligjit 8450 datë 24.02.1999 “Për përpunimin transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, duke e formuluar si më poshtë:
 “Shoqëritë e tregtimit më shumicë kanë të drejtë të kenë stacionet e tyre të shitjes së karburanteve, apo njësi të lëndëve djegëse. Në këtë rast atyre nuk ju lejohet që të vendosin çmime apo kushte të tjera tregtimi favorizuese ndaj këtyre stacioneve përkundrejt stacioneve të bardha”.
 - Në nenin 15 pika 2 të Ligjit Nr. 8450 datë 24.02.1999, të shtohet fjalia:
 “Kontratat e furnizimit, ndalohen të përmbajnë kushte që përcaktojnë çmimet e shitjes me pakicë, vendosjen e çmimeve minimum, si dhe vendosjen e kushteve të tjera të tregtimit që në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mund të çojnë në përcaktimin e çmimit. Kopje të këtyre kontratave i vihen në dispozicion Autoritetit të Konkurrencës, sa herë që kërkohen nga ky institucion.”
 - Ndryshimin e nenit 40 të Kodit doganor të Republikës së Shqipërisë, duke e formuluar si më poshtë:
 “Dogana merr parasysh gjithmonë kursin zyrtar të këmbimit të publikuar nga Banka e Shqipërisë, ditën e punës paraardhëse të procedurave të zhdoganimit”.
- II. T’i rekomandojë Ministrit të Financave të Republikës së Shqipërisë ndryshimin e pikës 9.4 të Udhëzimit Nr. 17 datë 13. 05. 2008 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”; duke vendosur një afat kohor, afat i cili të mundësojë realizimin e transparencës së çmimeve.
- III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm t’ua komunikojë këtë vendim organeve përkatëse.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ANËTARËT

Lush PERPALI	Servete GRUDA	Koço BROKA	Rezana KONOMI
(_____)	(_____)	(_____)	(_____)
Zv/Kryetar	Anëtare	Anëtar	Anëtare

Lindita MILO (LATI)

KRYETARE

Datë 29/5/2009

MENDIMI I PAKICËS

Lidhur me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr_118 Datë 29.05.2009 “Disa rekomandime për aktet ligjore dhe nënligjore që ndikojnë në konkurrencën në tregun e karburanteve” une shpreh pjesërisht kundërshtimet e mia për argumentat e paraqitura në vendim, si dhe sqarimin e votës kundra për shumicën e dispozitave të vendosura në të.

Lidhur me dispozitivin unë kam miratuar vetem paragrafin e fundit të pikës I të këtij dispozitivi, qe lidhet me ndryshimin e nenit 40 të Kodit Doganor.

Sic jam shprehur edhe më parë gjate shqyrtimit të “Raportit të Hetimit të Thelluar në Tregun e Karburanteve” nga ana e Grupi i Punës nuk është analizuar në mënyrë të plotë ndikimi i akteve ligjore dhe sidomos atyre nënligjore të Ministrise se Financave, Drejtorise së Përgjithshme të Doganave, Drejtorise së Përgjithshme të Tatimeve dhe praktikave te realizuara në zbatim te tyre nga ndërmarrjet që operojne në tregun e karburanteve.

Ky qendrim i Grupit te punes qe ka vazhduar edhe më pas pamvaresisht nga evidencat faktet provat e prezantuara është zhnduar në një qendrim refraktar.

Lidhur me ndikimin e akteve ligjore dhe nënligjore në kufizimin e konkurrencës në këtë treg do të rradhitja edhe argumentat ne vijim ku ndër to edhe deklarat e palëve në hetim në seancat dëgjimore. Palet nën hetim deklaruan se “Ky treg... por vuan nga deformimet që janë bërë duke ndërhyrë ligjerisht pa logjikë”¹

Më poshtë përfaqsesit e tyre vazhduan:

...”Ky është një fenomen që duhet të ishte problem dhe shkaktar kryesor i disa deformimeve qe konstatohen lehtesisht nqse do te njiheni me udhezimet qofte ato fiskale doganore dhe teknike që rregullojne karburantet, ky treg vuan nga cënimi i lirisë tij, prandaj në pamjen e parë nga analiza juaj dhe unë do te isha me ju, jep përshtypjen e çmimeve te kontrolluara dhe të unifikuara dhe etj., por grupi nuk është thelluar duke mos kontaktuar me ne dhe ndoshta është lënë për këtë seancë, të më falni se une proceduren nuk e njoh mire tuajen, jane keto vendime qe cenojne lirine e tregut qe pastaj deformojne ne pamjen e pare edhe cmimet, ne ckuptim ? duhet te njiheni me udhezimet dhe ligjet fiskale, te cilat ne menyre totale dhe doganore tentojne te barazojne midis ekonomive cmimin se ne blerje ashtu dhe ne shitje”.

Do të mjaftonin vetëm këto reshta për të evidentuar faktin se Grupi i punës ka punuar në mënyrë të përciptë dhe nuk ka bërë analizë të ndikimit të akteve ligjore dhe nënligjore në tregun të cilin kemi marrë në analizë dhe hetim në raport.

¹ Shih Zbardhja e Seances Degjimore mes AK dhe Kaspetrol dt.26/12/2008 faqe 3

Më tej në vendim Komisioni ka vlerësuar dhe konstatuar se udhëzimi nr.17, datë 15.05.2008 “Për TVSH-ë” më gjithë ndryshimet e mëtejshme që i janë bërë ka krijuar premisa për kufizimin e konkurrencës. Siç u citua dhe më sipër, në këtë udhëzim është përcaktuar roli i shoqërisë së tregtimit me pakicë si agjente dhe përfaqësuese e shoqërisë së tregtimit me shumicë duke favorizuar shoqëritë e integruara vertikalisht, mund të sjellë përjashtimin nga tregu, kohë pas kohe, aktorët e tjerë jo të integruar vertikalisht, ç’ka do të përbënte ulje të numrit të konkurrentëve në treg, pra drejtpërdrejt ulje dhe kufizim të konkurrencës.

Në këto rrethana kam kërkuar dhe kërkoj shfuqizimin e pikes 9.4 këtij udhëzimi si cënues i drejtpërdrejtë i konkurrencës në treg.

Ne kushtet kur kjo gje nuk më është marrë në konsideratë nga anëtarët e tjerë të komisionit, shpreh votën time kundër

Në qendrimin tim (Mendimin e Pakices) lidhur me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr 117, date 29.5.2009 “Mbi hetimin e thelluar në tregun e karburanteve” jam shprehur se çmimet e shitjes praktikisht e bashkerenduara (cmime te njejta tregu) në shitje, janë tek e fundit produkt i zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore fiskale realizuar nga Drejtoria e Pergjithshme Tatimeve dhe deget e saj dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave.

E njejta gjë është edhe përsa iu përket cmimeve në blerje (cmimeve ne dogane), ku drejtoria e Pergjithshme e Doganave nepermjet referencave dhe rregullave per faturimin e karburanteve.

Grupit të punës i është kërkuar nga ana e ime si komisioner ta evidentojë dhe analizojë një gjë të tillë, pra provat që hasen për këtë fenomen, madje të kërkohej për tu hetuar edhe me tej në këtë drejtim, por nga Raporti kjo punë rezulton e pa kryer. Çfarë do të thotë se janë shmangur provat dhe pistat e mundshme të hetimit duke i neglizhuar ato dhe duke i lënë jashtë raportit. Vijueshmërisht këto nuk janë marrë në konsideratë edhe nga anëtarët e tjerë të shumicës.

Sa më sipër duke mos qenë pjesërisht dakord me vlerësimin e fakteve të bëra në argumentet e pjesës konstatuese të vendimit, hartuar nga shumica, nuk mund të jem dakord dhe të miratoj dhe dispozitivin e këtij vendimi, i cili është rrjedhojë e drejtpërdrejtë e atyre konstatimeve, përjashtuar vetëm paragrafin e fundit të pikës së parë lidhur me ndryshimin në Kodin Doganor.

Prandaj çmoj që për pikat e tjera te dispozitivit te vendimit të jap votën kundër.

KOMISIONER I KONKURENCĒS

Koço BROKA
()
Anëtar